



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:001747  
Datë: 19.03.2024  
Numri i dokumentit: 05472426

C.nr.45/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtoren profesionale Shkurte Kadriu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B. K. e S. (B.), me seli në P., kundër të paditurit B. (B.) Q. nga fshati B., K. e Gj., me objekt kontesti rimbursimin e dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 565.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 11.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M  
N ë b a z ë t ë p o h i m i t

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses B.a K. e S. (B.), me seli në P. dhe DETYROHET i padituri B. (B.) Q.i nga fshati B., Komuna e Gj., që t'ia rimburoj shumën prej 565.00 euro, në emër të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 01.07.2021 në Prishtinë, me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë 05.01.2024 e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

II. Secila palë i bartë shpenzimet eveta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja B. K. e S.t (B.), me seli në P. më datë 05.01.2024, ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurit B. (B.) Q. nga fshati B., Komuna e G. për rimbursimin e dëmit material dhe jo material, me vlerë të kontestit prej 565.00 euro, duke theksuar se i padituri me datën 01.07.2021 rreth orës 17:45 minuta në Prishtinë, ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin Kawasaki me targa të regjistrimit X, ku deri te aksidenti ka ardhur kur automjeti "A", të cilin e drejtonte i padituri B. Q. nga pakujdesia i shkaktonte dëme të dëmtuarit F. R.. Në momentin e shkaktimit të këtij aksidenti automjeti i cili ishte shkaktar i aksidentit ka qenë pa mbulesë siguroese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit, e si rezultat i kësaj B.K. e Si. (B.), të dëmtuarit F. R. në respektim të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Nr.04/L-018 dhe në respektim të dispozitave të LMD-së, i ka kompensuar dëmin material dhe jomaterial të pësuar si rezultat i aksidentit. Andaj gjykatës i ka propozuar aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditëses B. K. e S. (B.), me seli në P. dhe detyrohet i

padituri B. (B.) Q. nga fshati B., Komuna e Gj.t, që t'ia rimburoj shumën prej 565.00 euro, në emër të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 01.07.2021 në P..

I padituri me anë të përgjigjes në padi të datës 21.02.2024, ka theksuar se e pohon dhe e konfirmon kërkesëpadinë e paditëses, pasi që me datë 01.07.2021 ka ndodhur aksidenti i komunikacionit ku ngasës i automjetit të njësisë "A", ka qenë vet i padituri. Andaj nga fakti se i padituri e ka pranuar shkaktimin e aksidentit me motoçikletë të tipit "Kawasaki", i njëjti me qëllim të efikasitetit dhe ekonomizimit të kësaj procedure kontestimore e pranon edhe përgjegjësinë për rimbursimin e dëmit, duke i propozuar gjykatës që të aprovet kërkesëpadija e paditëses, ku i padituri do të përmbushë obligimin financiar për shumën e rimbursimit të dëmit, kurse sa i përket shpenzimeve të procedurës, i njëjti i ka propozuar gjykatës që secila palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Gjykata në kuptim të nenit 148.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, pas pohimit të kërkesëpadiës nga ana e të paditurit ka konstatuar se në rastin konkret është fjala për kërkesa me të cilat palët mund të disponojnë lirisht, prandaj në kuptim të nenit 148.1 të LPK-së, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kamatës, gjykata u bazua në nenin 382 të LMD-së.

Për shpenzimet e procedurës gjykata, ka vendosur në bazë të nenit 450 të LPK-së.

Nga të lartëcekurat dhe bazuar në nenin 148 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.45/2024, me datë 11.03.2024

Gjyqtarja,  
Floriqe Qerimi

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimit të vendimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.